

BULETINI MUJOR



DHJETOR 2023

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



HIV/AIDS, MË SHUMË NDËRGJEGJËSIM DHE RRIJE TË KONTROLLEVE PERIODIKE

Në Ditën Botërore të luftës kundër HIV/AIDS-it, Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Albana Koçiu së bashku me mjekë të Spitalit Infektiv apeluan për rritjen e ndërgjegjësimit, informimin në kohë si dhe kryerjen e kontolleve periodike si elementë të rëndësishëm për parandalimin e infektimit nga kjo sëmundje.



KONFERENCA SHKENCORE KOMBËTARE E SËMUNDJEVE INFËKTIVE

Në Konferencën Shkencore Kombëtare të Sëmundjeve Infektive, Ministrja Albana Koçiu vuri në dukje se sot Shqipëria ka një infrastrukturë që mund të përballojë sfida të radhës, dhe se nuk do të mungojë mbështetja financiare edhe në vitin 2024 për sistemin shëndetësor.



BUXHETI 2024 / KOÇIU: RRETH 165 MIJË PERSONA MBËSHTETEN NË VIT NGA PROGRAMI I AK

Rreth 165 mijë persona që mbështeten në vit nga programi i aftësisë së kufizuar. Hartimi i politikave në rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj kësaj kategorie si dhe integrimi i tyre në tregun e punës, prioritet i qeverisë së MSHMS". Edhe buxheti 2024 parashikon mbështetjen e personave me AK dhe kujdestarëve të tyre.

PARANDALIMI I DHUNËS NDAJ VAJZAVE DHE GRAVE

Në aktivitetin ndërgjegjësues "Investo për të parandaluar dhunën ndaj vajzave dhe grave" u theksua se me buxhetin e vitit 2024, 300 milionë lekë janë në dispozicion për të mbështetur, viktimat e dhunës, shtresat në nevojë, nënat me fëmijë të vegjël, personat me AK, të moshuarit dhe kategoritë në nevojë.

PAKETA E SOLIDARITETIT PËR FUNDVIT

Dhurata e këtij fundviti, me kujdes të shtuar për familjet në nevojë, veçanërisht për fëmijët, të cilët do të kenë bonusin e festave, sipas kategorive përfituese. Përfitojnë 10,000 lekë 36 mijë familje me fëmijë në ndihmë ekonomike, 15 mijë fëmijë me aftësi te kufizuara dhe 400 fëmijë në kujdestari alternative.



www.shendetesia.gov.al



Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



ME BUXHETIN 2024 NIS RINKONSTRUKSIONI TOTAL I SPITALIT RAJONAL TË KORÇËS

Ministrja Koçi nga spitali i Korçës dha lajmin e mirë se struktura e Spitalit Rajonal të Korçës, i cili është një nga 12 spitalet rajonale, me buxhetin e viti 2024 do të transformohet. Znj. Koçi theksoi se spitali do të marrë dhe vëmendje të shtuar për të përmirësuar akoma më shumë cilësinë e shërbimit dhe për t'u dhënë mundësinë të gjithë personelit që punon aty për tu ndjerë më mirë. Spitali i Korçës ka të plotësuara më së miri të gjitha specialitetet e nevojshme për shërbimet spitalore, falë stafit dhe pajisjeve bashkëkohore.



QENDRA KOMBËTARE E URGJENCËS MJEKËSORE, RRETH 400 MISIONE NË BANESË DHE 2000 TELEFONATA ÇDO DITË

Gjatë një vizite në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Albana Koçi, se falë investimeve të qeverisë është fuqizuar dhe modernizuar flota e mjeteve të urgjencës paramjekësore me të gjithë mjetet jetëshpëtuese, duke iu përgjigjur mesatarisht në 15 minuta çdo thirrje për urgjencë mjekësore nga qytetarët në të gjithë territorin.



STRATEGJA NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT 2024–2030, PRIORITET RIINTEGRIMI DHE PUNËSIMI

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Albana Koçi mori pjesë sot në prezantimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimtit 2024–2030. MSHMS ka si mision mbrojtjen e viktimave ndaj dhunës, grupet e marginalizuara, ndërsa shtoi se ky dokument strategjik është një mburojë shtesë për të gjithë këto grupe. Koçi u shpreh se Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimtit 2024–2030 shkon në linjë dhe janë të ndërlidhura edhe me Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore, por edhe me strategjinë që MSHMS është duke hartuar për mbrojtjen sociale.



JO FEMINICIDIT! / MINISTRJA KOÇIU: I JAPIM GRUAS FORCËN EDHE ZËRIN E DUHUR NË SHOQËRİNË TONE

Në aktivitetin ndërgjegjësues "Jo Feminicidit! Bashkë kundër dhunës me bazë gjinore", të organizuar nga Kuvendi i Shqipërisë, Ministrja Koçi theksoi se miratimi i Plan-veprimit në zbatim të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, "Gruaja, paqja dhe siguria" është një lajm të mirë.

Ky angazhim i qeverisë do të jetë në agjendën dhe tryezën e çdo institucioni për të çuar akoma më përpara barazinë gjinore, duke e përfshirë atë në sektorë të rëndësishëm, si ai i mbrojtjes, sektori i rendit, në misione paqeruajtëse, por edhe jashtë. Me këtë plan, i jepet gruas roli që meriton.